



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE  
E ARTEVE E KOSOVËS



Nr. 740  
Dt. 10.09.2015  
PRISHTINË

## PROTOKOLLI (2015 – 2017)

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ARTISTIK MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim: ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim: ASHSH), në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000, për vitet 2015-2017, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimtari të përbashkëta:

**1. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërkademiç të gjuhës shqipe.** Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSHSHA, IGJL - QSA);

**2. Katalogu i përbashkët elektronik i fondeve albanologjike;**

**3. Letrat shqipe në gjuhë të huaj,** Konferencë shkencore ndërkombëtare, Tiranë, 2015;

**4. Studimet albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse,** Konferencë shkencore, Prishtinë, 2017;

**5. Për realitetet ekonomike dhe social-kulturore në tranzicion,** Konferencë ndërdisiplinore, Tiranë, 2017;

**6. Përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit;**

**7. Koncert i përbashkët veprash kamerale (muzikë dhome) dhe ekspozitë e përbashkët veprash pamore të anëtarëve të akademive, Tiranë – Prishtinë, 2016;**

**8. Ismail Kadare në 80-vjetorin e lindjes,** Konferencë shkencore, Tiranë, 2016;

**9. Idriz Ajeti në 100-vjetorin e lindjes,** Konferencë shkencore, Prishtinë, 2017;

**10. Ndre Mjedja në 150-vjetorin e lindjes,** Konferencë shkencore, Prishtinë, 2016;

**11. Isa Boletini në 100-vjetorin e vdekjes,** Tryezë shkencore, Prishtinë, 2016;

**12. Promovime veprash të rëndësishme shkencore dhe artistike të akademive (produksioni vjetor);**

**13. Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore;**

**14. Ligjërata të ndërsjella të akademikëve në tema të rëndësishme shkencore dhe artistike;**

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.


Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të burimeve financiare.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.


Nënshkruar në Prishtinë, më 10 shtator 2015, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
TË SHQIPËRISË

  
Akademik Vasil TOLE,

Sekretar Shkencor

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

  
Akademik Isuf KRASNIQI,

Sekretar i përgjithshëm

